



Planuar / Dërguar Punëpun./Prodator Received/Delivery		01.09.2022		viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedrnica Org /Unit	Nr. Prot Nr. Prot Prot No	Shtojca Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	5059/2022		116	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.649/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi - anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.649/2022 të datës 22.07.2022, të parashtruar nga ankuesit.

dhe sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore
nëpërmjet me adresë kundër
organit të punësimit Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 31.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.649/2022 e datës 22.07.2022 e parashtruar nga ankuesit: dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me datën 10.06.2022 kanë parashtruar kërkesë për Sekretarin e Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës lidhur me realizimin e shtesës në pagë në emër të rrezikshmërisë.

Pasi që nuk kanë marrë përgjigje nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 22.07.2022 kanë parashtruar ankesën me numër protokollit 4260/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e shtesës në pagë në mënyrë retroaktive për periudhën 01.01.2013 deri në datën e nxjerrjes së vendimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 28.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës, ndërsa me datë 19.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4813/2022 së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/104.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4260/2022 të datës 22.07.2022 me numër A.nr.649/2022 të parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 19.01.2012 për

Akt emërimi i datës 20.01.2012 për Vendimi i datës 14.02.2014 me nr.09/170 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesë për inspektimin e datës 14.08.2015; Raport zyrtar i datës 30.09.2015; Vendimi me nr.37-164/15 i Inspektorit të Punës; Kërkesa për shtesa e datës 17.06.2013 me nr.158; Njoftim i datës 04.07.2013 nga DASHC/MAP; Kërkesë e datës 18.07.2013 me nr.1878; Kërkesë e datës 24.04.2014 me nr.57; Kërkesë e datës 14.01.2015; Kërkesë e datës 14.08.2015; Kërkesë për shtesa i datës 25.04.2017 me nr.1364; Rekomandim për Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës i datës 04.07.2017; Kërkesë për hapësira të përshtatshme të punës e datës 20.11.2017; Shkresa e datës 24.11.2017; Njoftim i datës 23.02.2018 me nr.492 nga DASHC/MAP; kërkesë e datës 12.09.2019 për miratimin e shtesave në pagë për kushte specifike; Procedim i listës së pagave i datës 11.10.2017; Aprovimi i orarit të punës me ndërrime i datës 02.12.2015; Vendimi A.nr.132/2018 i datës 06.06.2018 me numër protokollit 3176/2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A.nr.497/2018 i datës 24.09.2018 me numër protokollit 5433/2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në padi e datës 11.09.2020; Akt emërimi i datës 25.10.2012 për Vendimi i datës 19.12.2012 me nr.14/109 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 14.02.2014 me nr.09/170 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Raporti i matjeve të dëmtuesve kimik dhe fizik e muajit dhjetor 2008; Prokurë speciale e datës 16.03.2022 nga Prokurë speciale e datës 15.04.2022 nga Prokurë speciale e datës 15.04.2022 nga Prokurë speciale e datës 15.04.2022 nga Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 19.08.2022 me numër protokollit 4813/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 30.04.2014 për Akt emërimi i datës 31.07.2013 për Akt emërimi i datës 25.10.2012 për Kërkesë e datës 16.05.2022 për Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës; E-mail zyrtar i datës 20.05.2022; Aktvendim i gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri në rastin KI117/16; Kërkesë e datës 06.11.2019; e-mail zyrtar i datës 17.10.2019; Procedimi në shtesën e pagave i datës 11.10.2017; Kërkesë për miratimin e shtesave në pagë për kushte specifike të punës e datës 12.09.2019; Ankesë e datës 13.03.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Lista e zyrtarëve dhe obligimet për inicimin e lëndës në Gjykatë sipas pëlqimit të dhënë më 12.03.2018; E-mail zyrtar i datës 27.02.2018; Njoftim i datës 13.02.2018 nga DASHC/MAP; Kërkesë e datës 07.02.2019; Shkresë e datës 24.11.2017; Kërkesa e datës 25.04.2017; Kërkesë e datës 14.01.2015; Kërkesë për shtesa e datës 17.06.2013; Matja e gazrave toksike dhe Matja e intensitetit të dozave ekspozuese të rrezatimit radioaktiv natyror në lokalet e Qendrës së Situatave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka gjetur se një grup tjetër i ankuesve të punësuar në institucionin e njëjtë me datë 13.03.2018 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e shtesave në pagën bazë për kushtet e punës duke u bazuar në bazën e njëjtë ligjore sipas pretendimit të ankuesve ndërsa më datë 21/09/2018 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerrë vendimin A.nr.497/2018 në lidhje me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se me datën 03.06.2022 menaxherja për personel dhe çështje ligjore e Këshillit të Sigurisë së Kosovës është përgjegjës lidhure me kërkesën e datës 20.05.2022 duke e arsyetuar se Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës nuk mund të paguaj asnjë lloj kompensimi të rrezikshmërisë pa një vendim paraprak të Qeverisë siç parashihet në dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *"1. Në institucionet e administratës publike, në të cilat ekziston nevoja që disa nëpunës civilë të punojnë në kushte specifike pune, ku si pjesë e detyrave të tyre të rregullta ata iu ekspozohen kushteve dhe kërkesave të veçanta në vendin e punës dhe që paraqesin rrezik për shëndetin, institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni. 2. Kriteret për përkufizimin e kushteve specifike të punës, shumta e shtesës si dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për shtesën për kushte specifike pune, përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa"*, ndërsa poashtu ka njoftuar se kompensimi për rrezikshmëri është në një proces gjyqësor në lidhje me disa zyrtarë tjerë dhe që ende nuk kemi vendim final në lidhje me këtë çështje, ndërsa sa i përket kompensimit të kujdestarisë e njëjta deklaroi se janë shterur të gjitha nivelet e gjyqësisë duke përfshi edhe Gjykatën Kushtetuese, ndërsa si provë na është dorëzuar edhe Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese për papranueshmëri në rastin KI117/16,Nr.Ref:RK 1084/17,i datës 05/06/2017.

Kolegji përkundër vendimit të mëhershëm të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe me qenë se lënda në proces gjyqësor nuk ka të bëjë me ankuesit dhe poashtu duke pasur parasysh faktin se vendimi final mund të ndërlihet me këtë objekt të ankesës por me qenë se nga palët nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar faktin se për të njëjtën çështje që është objekt i kësaj ankesë është duke u zhvilluar procesi gjyqësor, ka shqyrtuar prapë pretendimet ankimore të ankuesve, të cilët pretendojnë që Këshilli duhet ta obligoj Qeverinë e Republikës së Kosovës – Këshillin e Sigurisë së Kosovës që ankuesve në emër të kujdestarisë në punë dhe rrezikshmërisë në punë, t'u kompensojë në mënyrë retroaktive shtesën në pagë për periudhën 11.01.2013 dhe deri më datën e nxjerrjes së vendimit. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesit në bazë të akt emërimeve që i posedojmë në provat e lëndës kanë themeluar marrëdhënie pune në Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe në bazë të provave të lëndës që i posedojmë nga ankuesit dhe nga organi i punësimit, me datën 16.05.2022 përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve ka parashtruar kërkesë te Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështje në mënyrë miqësore jashtëgjyqësore për kompensimin shtesë sa i përket rrezikshmërisë dhe kujdestarisë së stafit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Zyra e Kryeministrit përmes e-mailit të datës 20.05.2022

ka njoftuar Sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës pasi kërkesa ka të bëjë me nëpunësit civil të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës duhet të merrni hapat e mëtejme lidhur me kërkesën e ankuesve.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga shkresat e lëndës ka konstatuar se zyrtarët e këtij institucioni vazhdimisht kanë parashtruar kërkesë në DASHC/MAP lidhur me shtesa në pagë për kushte specifike të punës, ndërsa me datën 13.02.2018 janë njoftuar nga DASHC/MAP se nuk janë plotësuar kriteret për shtesë në pagë për kushte specifike të punës për të punësuarit në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës nga se nuk kanë bazë ligjore në Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil dhe poashtu, Kolegji ka konstatuar se Ministri i Administratës Publike bazuar në Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ka themeluar Komisionin për shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës për nëpunësit civil, i cili Komision ka qenë funksional deri me datë 26.02.2018, përkatësisht deri me nxjerrjen e Vendimit Nr. 10/2018 të Ministrisë të Administratës Publike, me të cilin është anuluar vendimi Nr.34/2016 i datës 15.09.2016 mbi themelimin e këtij Komisioni.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil respektivisht nenin 16 paragrafin 1 dhe 2 ku parashihen shtesat mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës: "1. Në institucionet e administratës publike, në të cilat ekziston nevoja që disa nëpunës civilë të punojnë në kushte specifike pune, ku si pjesë e detyrave të tyre të rregullta ata iu ekspozohen kushteve dhe kërkesave të veçanta në vendin e punës dhe që paraqesin rrezik për shëndetin, institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni. 2. Kriteret për përkufizimin e kushteve specifike të punës, shuma e shtesës si dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për shtesën për kushte specifike pune, përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat" ka konstatuar se këto kërkesa sa i përket shtesave nuk kanë bazë ligjore si dhe janë në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1, nenin 2 paragrafi 2.1, 2.2, nenin 3 nënparagrafet 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4, nenin 4, nënparagrafi 4.1, 4.2, nenin 5 nënparagrafi 5.1 dhe 5.2 të rregullores 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të nëpunësve civil, ku specifikishtë parashihet: "1. Kushtet specifike të punës ndërlidhen me rrethanat, të cilat mund të paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën e nëpunësve civilë. 2. Kriteret, të cilat duhen përmbushur për përfitimin e shtesave për kushte specifike të punës, janë: 2.1 nëse rreziku për shëndetin dhe jetën e nëpunësit civil është i vazhdueshëm, me gjithë faktin se institucioni ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmirësimin e gjendjes gjatë një periudhe me kohëzgjatje njëvjeçare. 2.2 Kur natyra e punës është e tillë që kërkohet nga nëpunësi civil të jetë në kujdestari pasive 24 orë në ditë 3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës. 4. Ministria përgjegjëse për Administratë Publike pas shqyrtimit të kërkesës, mund: 4.1. Të aprovonjë shtesat për pozitën përkatëse dhe t'i propozojnë Qeverisë për miratim; 4.2. Ti propozojë institucionit ndryshim/plotësime eventuale të kërkesës së parashtruar; 5. Përlllogaritja e shumës së shtesës për kushte specifike të punës bëhet në bazë të pagës bazë për orë pune të

tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.649/2022, datë 31.08.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar,
- ❖ Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

